

KONTRATE PER SHITJE KUOTASH TE SHOQERISE "M-FASHION" SH.P.K

Sot me date 24/Maj/2024 (dymije e njezetekater) ne seline e Shoqersie M-Fashion shpk me NIPT K71807501B me ne Lagjia 17, Rruga Porto Romano LAGJA 17 Kryqezimi i Rruges PORTO ROMANO me Rrugen KULLA E SAHATIT , zona kadastrale 8517 (ish keneta) Durres Godine 3 kat nr 951, Durres Palet e meposhtme hartuan e kete kontrate per shitjen e kuotave te nje sh.p.k -je:

SHITESI: Z. Ardian Cenko , I biri Mitat , Lindur ne Durres me 4 Tetor 1964 , banues ne Durres ne L.1 Rr Taulantia , Pallati nr.1038 , mbajtes I kartes se identitetit nr. 034225673 me nr. personal G41004100P , ne cilesine e Ortakut me 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise M-FSHION Shpk , regjistruar ne QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) me numer Unik Identifikimi K71807501B me seline ne Lagjia 17, Rruga Porto Romano LAGJA 17 Kryqezimi i Rruges PORTO ROMANO me Rrugen KULLA E SAHATIT , zona kadastrale 8517 (ish keneta) Durres Godine 3 kat nr 951, Durres me kohezgjatje te papercaktuar dhe ka per objekt te veprimtarise te saj : Kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti: Import, eksport, prodhimin dhe tregtimin me shumicë e pakicë me anën e importit, eksportit të veshjeve e konfeksioneve të gjithëllojshme, etj , dhe me zotesi te plote per te vepruar (i referuar me poshte si SHITESI)

dhe

BLERESI: Z.a Silavana Berxulli , e bija Konstatndin , Lindur ne Durres me 12.07.1984 banues ne Durres ne Rruga "A. Goga" Lagja 11 , mbajttese e kartes se identitetit Nr. 034514496 dhe me nr. Personal I45712080V, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar (i referuar me poshte si BLERESI)

Duke marre parasysh se:

A) Shoqeria "M-FASHION" sh.p.k. (e referuar me poshte si SHOQERIA), eshte nje shoqeri e te drejtes shqiptare, e regjistruar rregullisht prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane me 04.06.2007 me



nr. regjistrimi 387477, dhe e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) me nr. unik te identifikimit K71807501B.

B) **SHITESI** eshte pronar i 1 (nje) kuote qe perfaqeson 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise "**M-FASHION**" sh.p.k dhe nepermjet vendimit te Asamblese Nr 2 te shoqerise "M-Fashion" shpk, e te dates 24/05/2024, ka shprehur vullnetin per te shitur 1 (nje) kuote qe perfaqesojne totalin e kuotave te shoqerise, domethene 100 % te kapitalit te shoqerise.

C) **BLERESI** ka shprehur vullnetin per te blere 1 (nje) kuote qe perfaqesojne totalin e kuotave te shoqerise, domethene 100 % te kapitalit te shoqerise.

PALET BIEN DAKORT TE HARTOJNE DHE TE FIRMOSIN KETE KONTRATE:

- a) Shitesi shet dhe bleresi blen 1 (nje) kuote qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise totalin e kuotave te shoqerise ne pronesi te shitesit sic jane identifikuar ne paragrafin B. Konkretisht 1 Kuote me vlere nominale 10.000.000 (dhjetemilion) Lek .
- b) Palet kane rene dakort qe cmimi i pergjithshem qe bleresi do te pagoje per transferimin e pronesise mbi te gjithe kapitalin te shoqerise eshte **10.000.000 (Dhjetemilion) Lek.**
- c) Pagesa do te behet me xhirim bankar brenda 60 ditesh nga firmosja e kontrates , respektivisht ne llogarine AL27209122400000250603740102 prane Procredit Bank.
- d) Mungesa e pageses, sipas gernes c , do te sjelle anullimin e kesaj kontrate dhe bleresi do te humbase pronesine mbi kuotat e shoqerise, te cilat do te kthehen automatikisht ne pronesi te "Z. Ardian Cenko. Pjesa e paguar e cmimit nese eshte bere pjeserisht do te mbahet nga Z. Ardian Cenko si demshperblim.
- e) Bleresi pranon dhe blen kuotat e permendura ne germen (a) e ne vleren e permendur ne germen b me kushtet e permendura ne germen c dhe (d) pa asnje pretendim apo kundeshtim te cdo natyre te tashme dhe/ose te ardhme te lidhura me to.

SHITESI DEKLARON DHE GARANTON BLERESIN PER SA ME POSHTE:

1. Shoqeria "M-FASHION" sh.p.k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe funksionon në baze të lejeve dhe autorizimeve të kërkuara nga ligji për ushtrimin e aktivitetit të saj.
2. Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga 10.000.000 (dhjetemiljo) Lek të ndarë në 1 kuotë në pronësi të Z. Ardian Cenko . Kuota përfaqëson 100% të kapitalit aktual. I gjithë kapitali është nënshkruar dhe është shlyer plotësisht nga ortakët dhe nuk ekziston asnjë detyrim i metejshëm për nënshkrimin ose shlyerjen e kapitalit themeltar. Shitesitë gëzojnë të drejtë të plotë pronësie mbi kuotat e tij në shoqëri dhe gjithashtu posedojnë dhe marrin çdo lloj tjetër fruti ose interesi që lind nga pronësia e kuotave.
3. Të gjitha lejet dhe autorizimet janë lëshuar në emër të shoqërisë dhe e lejojnë atë të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar në Shqipëri në përputhje me normat në fuqi. Shoqëria ka shlyer gjithashtu të gjitha detyrimet që janë të nevojshme për përshpalljet, vlerën dhe kohezgjatjen e lejeve dhe autorizimeve.
4. Asetet dhe pasuritë (të luajtshme dhe të paluajtshme) të shoqërisë janë të lira nga çfarëdo lloj pengu, hipoteke, dorezanie, garancie pasurore apo garanci të tjera reale ose personale, të cilat kanë ose mund të kenë efekte materiale negative mbi aktivitetin ose situatën financiare të shoqërisë.
5. Shitesitë deklarojnë që shoqëria nuk ka kryer asnjë akt ose aktivitet të kundërligjshëm duke vepruar gjithmonë konform ligjit. Të gjitha deklaratimet fiskale dhe raportet e shoqërisë të kërkuara nga ligji rezultojnë të depozituara pranë autoriteteve përkatëse. Informacionet dhe vlerësimet financiare janë dorëzuar sikundër rezultojnë gjithashtu të paguara të gjitha detyrimet fiskale, tarifën, pagesat dhe kontributet që duhen shlyer për shoqërinë, asetet ose të ardhurat e saj.
6. Shitesitë deklarojnë se nuk rezultojnë obligacione ose detyrime të pashlyera në kontratat ose marrëveshjet në të cilat shoqëria është palë dhe nuk ekziston asnjë arsye ose tregues për mosrespektimin e tyre. Shoqëria nuk është palë dhe nuk është në dijeni të jete palë në ndonjë çështje gjyqësore civile, penale, administrative ose arbitrazhi, zhvillimi i të cilave mund të ndikojë negativisht mbi transaksionet e shoqërisë, mbi kushtet e saj operative dhe financiare ose mbi kapacitetin e saj për përmbushjen e impenjimeve të mara.

BLERESI DEKLARON DHE GARANTON SHITESIN SA ME POSHTE:

- 1 Kjo kontratë krijon për blerësin një detyrim të vlefshëm dhe ligjor, shlyerja e të cilit nuk passjell asnjë shkelje të normave ose rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare të aplikueshme për blerësin.



- 2 Shitesi merr persiper cdo pergjegjesi ne lidhje me pretendimet eventuale qe mund te lindin ne drejtim te shoqerise per te gjitha aktet e kryera perpara dates se nenshkrimit te kesaj kontrate.
- 3 Per blerjen e kuotave bleresi duhet ti paguaje shitesit shumen prej 10.000.000 (Dhjetemilon) Lekesh si cmim i rene dakort per transferimin e kuotave qe perfaqesojne te gjithë kapitalin e shoqerise. Pagesa do te kryhet sikurse eshte parashikuar me lart ne geramat (c) .

Me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi mund te procedoje me transferimin e pronesise mbi kuotat dhe me rregjistrimin e ketij transferimi prane Qendres Kombetare te Bizmesit (QKB).

Ne daten e rregjistrimit bleresi do te konsiderohet pronar i vetem i te gjitha kuotave te shoqerise domethene te 100% te kapitalit te shoqerise "M-FASHION" sh.p.k , sikunder shitesi nuk do te kete me ne pronesi asnje kuote te kesaj shoqerie.

Ne rast mosmarrveshesh mes paleve ne lidhje me kete kontrate kompetenca eskluzeve i takon Gjykates Administartive te Shkalles se pare dhe do te rregullohen ne baze te legjislacionit shiptar.

Kjo kontrate u përpilua në 4 (katër) kopje origjinale ne italisht dhe 4 (katër) kopje origjinale ne shqip dhe ne rast mosmarrveshjeje mbizoteron version ne italisht.

SHITESI

ARDIAN CENKO

Aradian Cenko

BLERESI

SILVANA BERXULLI

Silvana Berxulli